



VENDIM

NR 5 DATA 19/06/ 2015

I MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME TË JASHTËZAKONSHME TË AKSIONAREVE TË SHQOËRISË ADMINISTRUESE TË FONDIT TË PENSIONIT, SICRED SH.A.

"MBI MIRATIMIN E
NDRYSHIMEVE NË STATUTIN
SI DHE
TEKSTIN E KONSOLIDUAR TË TIJ
NISTRUESE TE FONDIT TË PENSIONIT, SICRED SH.A."

me date **19.06.2015** në Mbledhjen e Asambleës së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të sionarëve të Shoqerisë "SICRED" sh.a., Shoqëri Administruese e Fondit te Pensioni, e cila bazuar Shpati u Shoqëri "SICRED" sh.a., Shoqëri Administruese e Fondit te Pensioni, date 31.10.2005, ligjin nr.10197, date 10.12.2009 "Për eferencat e pensionit vullnetar", dhe respektivisht neni 23 pikë(3; 24 e ne vijim; ne ligjin nr.10198, date 10.12.2009 "Per siplëmarrjet e investimeve kolektive", dhe përkushtivisht neneve 10, 11, 12, 13 e ne vijim; ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe qoqente Tregtarë" (i ndryshuar) ne nenin 135, pasi mos në shqyrtim Relacionin date **19.06.2015**, te taqitur që Administratori i Pergjithshmi i "SICRED" sh.a., Shoqëri Administruese e Fondit te pensioni, bazuar ne kompetencat qe i jep ligji, si dhe per mbarevajen e zhvillimit te punis,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet ne statut si dhe tekstein e konsoliduar, të tij, te shoqerisë SiCRED sh.a., shoqeri administruuese e fondeve te pensionit vullnetar, sipas teksteve bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Me zbatimin si dhe ndjekjen e procedurave të këtij vendimi për muratimin e tij, pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ngarkohet Administratori i Përgjithshem i Shoqerisë Administruuese e Fondit të Pensionit, "SiCRED" sh.a.
 3. Ky Vendim hyr në fuqi menjëherë, dhe prodhon efekte vetëm pas miratimit te kryer nga autoriteti kompetent i përcaktuar ne pikën 2 te këtij vendimi.

Një ledhja u mbajt me pjesëmarrjen e:

Bēr-Banka CREDINS sh.a. zīmērūs 76 % tē paketēs aksionare:

Për SiCRED sh.a. (shoqeri sigurimi jetë) ZOGU

Pēr KURUM INTERNATIONAL sh.a., zotērues nē 8.37% te paketes aksionare

(përfaqësues i autorizuar i KURUM International sh.a.)

Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 5
Bv. "Brigada VIII", Vila Nr. 3/t, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 22 37 549
pensions@sicred.com.al

MHS: MSS110098

Lista e pjesëmarrësve ne takimin e datës 19/06/2015

Për Banka CREDINS sh.a. zotëruan 76 % të paketës aksionare:

Momtaz Bello (përfaqësues i autorizuar i Banka CREDINS sh.a.)

Për SiCRED sh.a. (shoqeri sigurimi) është Pensions 15,63% të paketës aksionare:

Genc KOXHAJ (përfaqësues i autorizuar) / SICRED Shqipëri

RE-KURUM INTERNATIONAL sh.a., zotērues nē 8.37% tē paketēs aksionare.

(përfaqiçues i autorizuar i KURUM International sh.a.)

STATUTI
I
SHOQËRISË ADMINISTRUUESE
TË FONDEVE
TË PENSIONIT "SiCRED" SH.A

Neni 1 – Emri i Shoqërisë

1.1 Emërtimi i shoqërisë është "SiCRED sh.a.– Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit" më poshtë e quajtur "Shoqëria".

1.2 Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SiCRED" sh.a., është një shoqëri akcionare, e themeluar rregullisht në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2 – Selia

- 2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën Rr. "Njësia Bashkiake Nr.5, Rr. "Brigada VIII", Vila Nr. 3/1, Tiranë".
- 2.2 Shoqëria ushton aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë.
- 2.3 Mbledhja e Aksionareve të Shoqërisë, mund të vendojë krijimin ose mbylljen e sëllive dytësore, zyra, dege të shoqërisë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përvç selisë qendrore të Shoqërisë, në Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 – Qëllimi

3.1 Qëllimi i veprimitarës së Shoqërisë është:

3.1.1 Mbledhja dhe investimi i fondeve të pensioneve, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10197, datë 10.12.2009: "Për fondet e pensionit vulnëtar", akteve nënligjore te dala ne zbatim te tij, si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së riskut (diversifikim), përimin e përfitimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit.

3.1.2 Kryerja e pagesave të pensionit.

3.1.3 Për arritjen e këtij qëllimi, Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridike dhe fizike brenda dhe jashtë vendit te cilët kanë të njëjtin qëllim.

3.2 Themeli i dhe/ose administrimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive, që ushthetet ne përputhje me dispozitat e ligjit nr.10198, date 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", akteve nënligjore te dala ne zbatim te tij, ligjet nr.9879, datë 21.02.2008, "Për titujt", si dhe të qdo parashikimi te përcaktuar ne legjislacionin ne fugi, te lidhur me emetimin e shijen e kuotave dhe të aksioneve; dhe shlyerjen e kuotave; administrimin e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive; marketimin e

sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shijen e kuotave në fondet e investimit ose të aksioneve në shoqëritë e investimit; kryerjen e detyrave administrative, që përcaktohen ne ligj dhe ne akte nënligjore te tjera.

Neni 4 - Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është e papërcaktuar.

Neni 5 – Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali i nënshkruar dhe i paguar tërësisht i shoqërisë është **60,689,994.00** lekë i përbërë prej **148,024.38** aksione me vlerë nominale 410 (katërqindëdhjetë) lekë secili.

5.2 Kapitali aksionar i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontributet në para (likuidet) dhe zotërohet nga aksionarët e Shoqërisë si më poshtë vijon:

a) Pjesëmarrja aksionare e **BANKA CREDINS sh.a.** është në nivelin **76%**, te kapitalit aksionar me barasvlerën ne leke prej 10,658,514 si dhe me 25,996.38 aksione.

c) Pjesëmarrja e Aksionarit **KURUM INTERNATIONAL sh.a.**, është në nivelin **6,44%**, te kapitalit aksionar me barasvlerën ne leke prej 3,906,890 si dhe me 9,529 aksione.

Neni 6 - Aksionet

6.1 Aksionet janë nominativë dhe të pandashëm. Aksionarët e regjistruar në Regjistrin e Aksionarëve kanë të drejtën e ushtrimit të votës. Çdo aksion i jep zotërueshëtë tij të drejtën e një vote.

6.2 Të gjithë aksionet janë të zakonshme dhe regjistrohen në Regjistrin/Librin e Aksionarëve të Shoqërisë, që pasqyron:
(i) emri i aksionarit,
(ii) adresë,
(iii) numri i vlera nominale e aksioneve të zotëruara nga aksionari, dhe
(iv) data e kryerjes së regjistrimit.

6.3 Regjistri mbahet pranë Shoqërisë nga Administratori i Shoqërisë ose nga çdo person tjetër i caktuar prej tij, i cili regjistron të gjitha zërat me kërkesën e personit të interesuar, nëpërmjet paraqitjes së dokumentit që provon të drejtën përkatëse.



6.4 Të gjitha ndryshimet në lidhje me aksionet duhet të pasqyrohen/regjistrohen në Regjistr. Informacioni i Regjistrit të Aksioneve duhet të publikohet në faqen e internetit të Shoqërisë.

Neni 7 - Zmadhimi i kapitalit

7.1 Asambleja e Aksionarëve mund të zmadhojë pa kufizim kapitalin e Shoqërisë, në përpunje me dispozitat ligjore në fuqi. Në këtë rast, vendimi duhet të merret gjithmonë me $\frac{1}{4}$ e votave të aksionareve që marrin pjesë në votim.

7.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontributë në natyrë. Kapitali themeltar mund të rritet, nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve. Në çdo rast këto kontributë duhet të shoqërohen me një certifikatë për nënshkrimin e tyre ose një raport vlerësimi të kontributeve të kryer nga një ekspert i vlerësimit të kontributeve në natyrë.

7.3 Kontributet në të holla për aksione të nënshkruara sipas vendimit të Asamblesë së Aksionareve për mijen e kapitalit duhet të paguhën të paktën $\frac{1}{4}$ te vlerës nominale në momentin e nënshkrimit. Pjesa që mbetet do të paguhet në përpunje me vendimin e Këshillit të Administrimit dhe në përpunje të plotë me rregullat e vendosura për këtë qëllim nga autoritetet publike mbikëqyrëse të aktivitetve të sigurimit.

7.4 Pavarësisht sa më sipër, Asambleja e Aksionarëve që vendos rritjen e kapitalit, ka të drejtë të vendosë pagimin e plotë të aksioneve nga momenti i nënshkrimit ose duke filluar nga nënshkrimi ose brenda një afati më të shkurtër se afati i përmendorur në pikën 7.3 të këtij neni. Në rast vonese në pagesh, aksionari në mos përbushje do të pagujë interesat në përpunje me përqindjet ligjore, duke filluar nga data e përcaktuar për çdo pagesh, pa qenë të nevojshme formalizata të tjera dhe asnjë heqje dore e Shoqërisë kundrejt aksionarit ne mos përbushje.

7.5 Vendimi për zmadhimin e kapitalit i njofshet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikohet në faqen e internetit të Shoqërisë.

Neni 8 - Zvogëlimi i Kapitalit

8.1 Asambleja e Aksionarëve mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, në përpunje me dispozitat ligjore në fuqi. Në këtë rast, vendimi duhet të merret gjithmonë me $\frac{1}{4}$ e votave të Aksionarëve që marrin pjesë në votim. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e vendosur nga Ligji.

8.2 Aksionarët përballojnë zvogëlimin në përpunje me aksionet që zotërojnë në kapital.

8.3 Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njofshet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikohet në faqen e internetit të Shoqërisë.



Neni 9 – Transferimi i Aksioneve dhe e Drejta e parablerjes

9.1 Aksionet e Shoqërisë janë lirish të transferueshme midis Aksionarëve të Shoqërisë, pjesërisht ose plotësisht. Transferimi mund të realizohet nëpërmjet shijes, trashëgimisë, dhurimit ose në çdo formë tjetër të parashikuar në ligj. Transferimi i aksioneve nuk mund të realizohet pranë të tretëve, nëse më parë nuk është ushtruar e drejta e parablerjes në favor të aksionarëve të tjerë ekzistues.

Megjithatë, në këtë rast, transferimi duhet t'u komunikohet me shkrim aksionarëve të tjerë të Shoqërisë.

9.2 Çdo aksionar që ka për qellin transferimin e pjesës së tij të kapitalit në Shoqëri, në tërësi apo pjesërisht, personave të tretë do të njofje me shkrim si Aksionarët e tjerë ashtu dhe Shoqërinë (në vijim "Njoftimi"), duke specifikuar të gjitha afatet dhe kushtet e ofertës, qmimin, afatet, kushtet, emrin e aksionarit transferues dhe kushtet e kalimit. Aksionarët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së aksioneve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtronin këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marja e komunikimit të vullnetit të aksionarit për të transferuar aksionet përkatës.

9.3 Çdo kalim i parashikuar nga neni 9.2 i mësipërm i nënshtrohet të drejtës së refuzimit të parë në favor të Aksionarëve të tjerë.

9.4 Çdo transferim i aksioneve në kundërshtim me këtë nen do të jetë nul dhe i pavlefshëm.

Neni 10 – Organet drejtuese të Shoqërisë

10.1 Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli i Administrimit, si organ i vetëm administrimi, i cili ushton, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje, të veprimitarës së shoqërisë (sistemi me një nivel).

Neni 11 – Asambleja e Përgjithshme, të Drejtat dhe Detyrimet

11.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtarë;
- b) ndryshimi të statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit (sistemi me një nivel);
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendorur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;



- dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - ë) zymadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - f) pjesëtimin e akioneve dhe anulimin e tyre;
 - g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - gu) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statut.
- 11.2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin e eksperit kontabël të autorizuar.

Neni 12- Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1. Asambleja e Përgjithshme do të thirret në rastet e parashikuara nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Statuti dhe sa herë që është c nevojsime me qëllim mbrojtjen e interesave të Shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë se përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- 12.2. Asambleja e Aksionarëve thirret nga Administratorët që do rastet e parashikuara nga ligji nga anëtarët e Këshillit të Administrimit, si dhe mund të thirret që aksionarët në përpunje me nenin 139 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 13 - Mënyra e Thirrjes, Rendi i Ditës

- 13.1. Mbledhja e Asamblesë se Aksionarëve do t'u njoftohet aksionarëve me shkrim apo nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve të paktën 21 ditë kalendareke përparrat datës së parashikuar të mbledhjes.
- 13.2. Asambleja e Aksionarëve do të konsiderohet e mbajtur rregullisht edhe në rast se nuk janë respektuar formalitetet e thirrjes, në rast se janë të pranishëm të gjithë Aksionarët dhe shprehen dakord për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

Neni 14-Përfaqësimi në Asamble, Pjesëmarrja në Asamble

- 14.1. Një aksionar mund të përfaqësohet në asambleën e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.
- 14.2. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



- 14.3. Aksionarët që nuk janë të pranishëm në mbledhjen e thirrur për t'u zhvilluar, mund të janë pjesëmarrës në mbledhje, duke përdorur mijet elektronike të komunikimit, telekonferencë, videokonferencë apo mijetë të tjera të komunikimit elektronik, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të janë identifikuar dhe t'u jetë dhëne mundësia për të ndjekur diskutimin e komunikimit e ndërsjellje të kohës reale nga një vendndodhje tjeter, duke përdorur mijetë teknike të nevojsime për përdorimin proporcional për arritjen e këtyre qëllimeve. Nëse plotësohen dhe zbatohen këto kriterë, Asambleja e Aksionarëve do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhet kryetari dhe sekretari i mbledhjes, me qëllim mbajtjen e minutave të takimit, nënshkrimin e procesverbaleve përkatëse.
- 14.4. Aksionarët të cilët janë regjistruar në regjistrin e akioneve si aksionarët të cilët depozitojnë aksinet e tyre në përpunje me udhëzimet dhe kushtet e vendosura në njofrimin e thirrjes, mund të marrin pjesë në Asambleën e Aksionarëve.
- 14.5. Aksionarët mund të caktojnë një person që do të kryesojë Mbledhjen e Aksionarëve. Asambleja e Aksionarëve emrën një sekretar të mbledhjes i cili mund të jetë aksionar osë aksionar.
- 14.6. Kryetari i Asamblesë së Aksionarëve ka tagra të plota për të verifikuar autorizimet/prokurat e regjullsine e tyre, të drejtat e aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asambleën e Aksionarëve, dhe të përcaktojë nëse kjo asamble është e thirrur rregullisht dhc nëse është i pranishëm kuromi i aksionarëve me qëllim marjen e vendimeve të vlefshme; gjithashtu ai ka të drejtoj të drejtë diskutimet dhe të përcaktojë mënyrat dhe procedurat e votimit.
- 14.7. Prosesverbalët e mbledhjes nënshkruhen nga Kryetari i Mbledhjes dhe nga Sekretari.

Neni 15 – Këshilli i Administrimit (sistemi me një nivel)

- 15.1. Këshilli i Administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
- a) të jepë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
 - c) të përgatisë, me kërkcesh të asamblesë së përgjithshme, marjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, të rekandomjës asaj vendime të nevojsime për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
 - d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standarde të kontabilitetit;
 - dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivitetet e shoqërisë;
 - e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga Administratorët. Këto dokumente duhet të statutit, të përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Page 6 of 12

- miratohen e tē nēnshkruhen nga tē gjithë e Anëtarët e Këshillit tē Administrimit pér t'u paraqitur asamblese së përgjithshme, së bashku me një raport tē këshillit tē administrimit pér miratim dhe një përshkrim pér mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë tē gjithë vitit finanziar;
- e) tē sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël tē kryhet tē paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarrur e raporti i auditimit, drejtuar asamblese së përgjithshme, i u vlerës në dispozicion tē gjithë anëtarëve të Këshillit e Administratoreve. Raporti i Këshillit tē Administrimit, përmendor në shkrinjën "e" tē kësaj pike, duhet tē përbajë edhe mendimin pér raportin e auditimit;
 - f) tē emërojë dñe tē shkarkojë administratorët, tē ndajë kompetencat ndërmjet tyre;
 - g) tē përcaktojë shpërbliminë e administratorëve;
 - gj) tē miratojë marrjen përsipër tē detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 pér qind tē aseteve tē shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, tē çertifikuar, nëpërmjet nēnshkrimit tē huave apo emetimit tē obligacioneve apo instrumenteve tē tjera tē borxhit;
 - k) tē vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, pér themelimin e shoqërive tregtare ose tē grupeve tē reja;
 - i) tē kryje tē veprimet e tjera, tē përcaktuara nē ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, "Pér tregtaret dhe shoqëritë tregtare", nē ligjin nr.10197, datë 10.12.2009; "Pér sipërmarrjet e pensionit vullnetar", nē ligjin nr.10198, datë 10.12.2009; "Pér sipërmarrjet e investimeve kolektive", nē ligjin nr.9879, datë 21.02.2008; "Pér titujt", si dñe nē Statut.
 - 15.2. Në rastet e parashikuara nē pikat 3, 4 e 5 tē nenit 136 tē ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Pér tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Këshilli i Administrimit duhet tē thërrasë menjëherë Asambleë e Përgjithshme, pér tē shqyrtuar nēse shoqëria duhet tē prishet ose pér marrjen e masave tē tjera tē nevojshme e tē përshtatshme.

Neni 16 Numri, Emërimi Dhe Përberja E Këshillit Të Administrimit

- 16.1 Këshilli Administrimit do tē përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, por nē qdo rast kjo numër anëtarësh nuk do tē jetë më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët caktohen nga Asambleja e Aksionarëve në përpjekte me kufizime e ligjt nr.9901 datë 14.4.2008, "Pér tregtaret dhe shoqëritë tregtare". Anëtarët e Këshillit i Administrimit zgjedhin nga radhët e tyre Kryetarin si dhe Zëvendëskryetarin, si dñe mund tē zgjedhin edhe Administratorët. Anëtarët e Këshillit tē Administrimit mund ta kryejnë detyrit e Administratorit, pér sa kohë shumica e anëtarëve tē Këshillit tē Administrimit janë anëtarë tē pavarr, që nuk kryejnë këtë detyri. Një administrator nuk mund tē zgjidhet Kryetar i Këshillit tē Administrimit. Këshilli i Administrimit, ushton funksionet në përpjekte me parashikimet e legjislacionit nē fuqi, këtij Statuti dhe Rregullorët e Brendshme tē tij.
- 16.2 Mandati i anëtarëve tē Këshillit tē Administrimit është tre vjeçar dhe ata janë tē rizgjedhshëm në këtë detyri. Anëtarët e emëruar nga Asambleja e Aksionarëve mund tē revokohen pér çfarëdo arsy nga Asambleja e Aksionarëve.



Neni 17 – Mbledhjet e Këshillit tē Administrimit

- 17.1 Këshilli i Administrimit thirret zakonisht tē paktën qdo tre muaj dhe sa herë e kërkon interesë i shoqërisë, me thirrjen e Kryetarit ose, nē mungese tē tij nga Zëvendëskryetari.
- 17.2 Kryetari, nē mungese tē tij Zëvendëskryetari i caktuar pér ta përfaqësuar, do tē thërrasë Këshillin e Administrimit nē bazë tē një kërkesë tē arsyetur tē Bordit te Drejtoreve ose tē paktën tra anëtarëve tē Këshillit tē Administrimit. Nëse kjo kërkesë mbetet pa përgjigje pér dhetë ditë, atëherë autor i saj mund tē thërrasë mbledhjen e Këshillit, duke përcaktuar dha Rendin e Dites.
- 17.3 Thirrja kryhet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbledhjes nëpërmjet letrës, telegramit, teleks os faks. Thirrja mund tē bëhet edhe gojarisht dha pa kufij kohor nēse anëtarët e Këshillit tē Administrimit do ta pranojnë.
- 17.4 Qdo thirrje do tē përfshije rendin e propozuar pér mbledhjen, si dhe dokumentacionin e çështjeve tē rendjeve tē ditës.
- 17.5 Procesverballet mbahen nga sekretari dhe nēnshkruhen prej tij dhe prej Kryetarit, nē mungesë tē tij prej Zëvendëskryetarit tē caktuar pér ta përfaqësuar, nē Këshillin e Administrimit. Prosesverbal, përmbar vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim pér çështjet e diskutuar dhe vendimet e marra. Parregullisët pér mbajtjen e procesverbalist, nuk kanë si posojë pavlefshëmërinë e vendimeve tē marra. Cecili anëtar ka tē drejtë tē marrë një kopje tē procesverbaltit.
- 17.6 Vendimet e Këshillit tē Administrimit vlerësohen tē vlefshme, nëse nē procesin e vendimmarjeve janë tē pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave tē anëtarëve tē pranishëm dhe kur pér një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotzon.
- 17.7 Vendimet e Këshillit tē Administrimit, mund tē merren sipas përcaktimeve tē statutit apo tē rregullloreve tē këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete tē tjera tē komunikimit elektronik, me përgjashim tē rasteve kur një anëtar i këshillit, ka kundërshtime pér këtë ménçrë vendimmarjeje.
- 17.8 Anëtarët e Këshillit që nuk janë tē pranishëm nē mbledhjen tē thirru pér t'u zhvilluar, mund tē jenë pjesëmarrës nē mbledhje, duke përdorur mjete elektronike tē komunikimit, telekonferencë, videokonferencë apo mjete tē tjera tē komunikimit elektronik, me kusht që tē gjithë pjesëmarrësit tē jenë identifikuar dhe t'u jetë dhëne mundësia pér tē ndjekur diskutimin dhe komunikimin e ndërsjellë ne kohë reale nga një vendndodhje tjeter, duke përdorur mjete teknike tē nevojshme pér përdorimin proporcional pér arritjen e qëllimeve tē sipërpërmendura. Nëse plotësohen këto kushte dhe nē rastet kur zbatohen këto kriterio, mbledhja e Anëtarëve tē Këshillit do tē konsiderohet e mbledhur nē vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim mbajtjen e minutave tē takimit, si dhe nēnshkrimin e procesverbaleve përkatëse.



Neni 18 - Administratorët

18.1 Këshilli i Administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë, si administratorë të shoqërisë, pë një afat, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen.

18.2 Administratori/Administratorët emërohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ligjit nr.10 197, date 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", si dhe të ligjit nr.10198, date 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

18.3 Administratorët kanë të drejtë dhe dytore:

- a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarës tregtare të shoqërisë;
- b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdesen për mbajtjen e sakte të rregullit të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisin dha të nënshkruanj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarës, të cilët ia paraqesin Këshillit të Administrimit për miratim, sebasiku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për tu paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
- d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërkojnë ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejnë regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ketij ligji apo të ligjeve të tjera;
- e) të raportojnë përpjekur Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimitarët e shoqërisë;
- ë) të kryejnë dytë të tjera, të përcaktuara në ligjin nr.9901, date 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe në ligjin nr.10 197, date 10.12.2009: "Për fondet e pensionit vullnetar", si ligjin nr.10 198, date 10.12.2009: "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe ato të deleguara nga Këshilli i Administrimit.

Neni 19 – Audit i Brendshëm i Shoqërisë

19.1 Audit i Brendshëm i Shoqërisë përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të përhershëm të emëruar nga Këshilli i Administrimit dhe ushtron veprimitarinë nën mbikëqyrjen direktë të Këshillit të Administrimit.

19.2 Këshilli i Administrimit, përcakton dispozitat rregulluese lidhur me realizimin e kontrollit finansiar të brendshëm të shoqërisë dhe miraton planin vjetor të auditimit.

19.3 Audit i Brendshëm i Shoqërisë i raporton Këshillit të Administrimit të paktën katër herë në vit.

19.4 Audit i Brendshëm është përgjegjës:

- a) për të rekomanduar parimet e mirëdrijimit të shoqërisë, politikat dhe strategjiet për t'iu përbajtj parimeve dhe për të vlerësuar çdo vit zbatimin e kështje politikave e



strategjive. Parimet e mirëdrijimit të shoqërisë duhet të përfshijnë standartet e kryerjes së biznesit e të sjelljes etike të administratorëve, të drejtuesve të personelit jetër, politikat për transaksionet private, bëjen të marrëveshjeve me veteven dhe praktika të tjera transaksionesh, kur palët nuk janë të pavarrura;
b) për të mbikëqyrur veprimet e shoqërisë administratorët dëshëruan të dhënë udhëzime për të, në mënyrë të përditshme, për të siguruar se shoqëria u përmbarat objektivave e politikave të miratura nga Këshilli i Administrimit dështimët e legjislacioni përkatesh;
c) për të dhënë rekondadimt për Këshillit e Administrimit, për rishikimtët e miratimin prej tij të objektivave, strategjive, planeve të biznesit dhe politikave madhore, që udhëheqin veprimin e institucionit;
ç) për t'i siguruar Këshillit të Administrimit informacionin përkatesh, të hollesishëm e në kohën e duhur, në mënyrë që ky Këshill të mund të rishikojë objektivat e biznesit, strategjinë e biznesit dhe politikat dështimët e tij të bëre strukturat më të larta drejtuese përgjegjës për pozicionin e tyre.

Neni 20 - Struktura e Administrimit të Riskut

20.1 Struktura e Administrimit të Riskut, përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të përhershëm të emëruar nga Këshilli i Administrimit dhe ushtron veprimitarinë nën mbikëqyrjen direktë të Këshillit të Administrimit.

20.2 Struktura e Administrimit të Riskut është përgjegjës që:

- a) t'i rekomandojë Këshillit të Administrimit miratimin e një strukturë të administrimit të riskut, që të identifikojë të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme risqet, para të cilave janë të eksponuara asetat e fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit; dhe shoqëri administruese, përfshirë, të paktën, riskun e tregut, riskun e kredisë, riskun operacional, riskun e reputacionit, riskun ligjor dështimët e agjencisë;
 - b) të mbikëqyrë veprimet e shoqërisë administratorët dështimët;
 - c) të jepë udhëzime të përditshme, për të siguruar që shoqëria administratorët, vetë apo/duhet t'ë rolin e administrimit të fondit/fondeve të pensionit; dështimët;
 - ç) të shprehurët të kontraten të fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit dështimët;
 - ë) të përcaktojë sakte dështimët të pensionit; fondit/fondeve të investimit.
- c) të përcaktojë sakte dështimët të pensionit; fondit/fondeve të investimit.

Neni 21 – Auditësit e Jashtëm

21.1 Kontrolli i jashtëm finansiar i shoqërisë administratorët të fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit bëhet nga një ose më shumë auditues të jashtëm të autorizuar, në përputhje me standartet e njohura ndërkombëtare të auditimit.



Page 10 of 12

21.2 Llogaritë e shoqërisë dhe të fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit që administron auditohen qdo vit ushtrimor dhe në afate të tjera të ndërmjetme, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi, dhe në shoqëritë e kontrolluara, sipas legjislacionit ne fuqi, duhet te paragjeshë te dyja grupet e pasqyrave financiare vjetore te kontrolluara, atë individuale dhe ato te konsoliduara.

21.3 Audituesi/it e jashtëm të Autorizuar që emërohen nga Asambleja e Aksionarëve, duhet që të gjëzojnë statusin e personit juridik të miratuar nga autoritetet përgjegjëse me ligj.

Neni 22 – Viti ushtrimor

22.1 Viti ushtrimor fillon më 1 Janar dhe mbarton në 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 23 – Politika e Investimeve

23.1. Këshilli i Administrimit miraton politikat e investimit, në përputhje me ligjin e regjulloreve në zbatim të këtij ligji, mbikëqyr administrimin e investimeve të fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit, siguron që përbërija e diversifikimi i tyre të përcaktohen në mënyrën e duhur në politikën e investimit, te fondit/fondeve të pensionit; fondit/fondeve të investimit. Politika e investimit, në kuptim të kësaj pike, përfshin:

- a) kufijtë për shumat, që mund të mbahen në lloje të veçanta investimesh;
- b) përcaktimin e qartë të llojeve të instrumenteve financiare dhe të çdo aseti tjetër, në të cilin mund të investohet fondi i pensionit; dhe fondi i investimit;
- c) regulla për rruajjen e aseteve të anëtarëve;
- d) vlerësimin e përputhjes së duhur të aseteve dhe të detyrimeve;
- e) procedurën e duhur për mbikëqyrjen e nivelit të likuiditetit;
- f) çdo përcaktim që parashikohet ne ligjin nr.10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", ligjt nr.10 198, datë 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe ne aktet e tjera ligjore dhe nënligjore ne fuqi.

23.2. Këshilli i Administrimit miraton sistemin e administrimit të risikut përfondin e pensionit, fondin e investimit që përfshin përcaktimin dhe monitorimin e politikave, me qëllim identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin, në mënyrë të vazhdueshme, të gjitha risqet kryesore.

Neni 24 – Rezerva ligjore dhe Rezervat e Tjera

24.1 Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit finanziar paraardhës, duke zbritur shpenzimet Shoqëria duhet te kalojë ne rezervën ligjore, te pakën 5% te kësaj vlerë, derisa kjo rezerve te jenë e barabarte me 10 % te kapitalit te regjistruar te Shoqërisë në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

24.2 Me vendim te asamblesë se jashtëzakonshme te aksionareve sipas parashikimeve te këtij Statuti, mund te parashikohen krijime rezervash te tjera nga fitimet vjetore.

24.3 Shoqëria llogarit dhe ndan dividentet, vetëm pasi nga fitimi vjetor te jene zbritur shumat e caktuara ne pikat 1 dhe 2 te këtij nen, si dhe ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 25 – Prishja dhe Likuidimi

25.1 Shoqëria konsiderohet e prishur në rastet e parashikuara nga ligji i zbatueshëm. Në rast përfundimi, Asambleja e Aksionarëve emëron një ose më shumë likuidues dhe tagrat përkatësë në përputhje edhe me kërkosat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, si dhe ligjt nr.10 197, date 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", ligjt nr.10 198, date 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Neni 26 – Blerja, Bashkimi dhe Transferimi i Shoqërisë

26.1 Shoqëria mund të blejë dhe te zoteroje aksione në një shoqëri tjetër, sipas parashikimeve te ligjit nr.9901, date 14.04.2008, si dhe ligjt nr.10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", ligjt nr.10 198, datë 10.12.2009, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", me vendim të Asambleës së Aksionarëve, si dhe pas dhënies së pëlgimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje ne gjuhën shqipe.

Lexuar, kuptuar, miratuar dhe nënshkruar nga aksionarët, sot në:

Tiranë, më 19.06.2015

